



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr.26, datë 20.11.2024

PËR

**DISA NDRYSHIMEVE TË LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINË
POLIFUNKSIONALE 4, 5, 11 DHE 21 KATE, ME 3 KATE NËNTOKË “BOOK
BUILDING”, NDËRMJET RRUGËS “28 NËNTORI” DHE RRUGËS “ABDI TOPTANI,
BASHKIA TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Techno-Alb” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në Lejen e Zhvillimit për objektin: “Godinë polifunksionale 4, 5, 11 dhe 21 kate, me 3 kate nëntokë “Book Building”, ndërmjet Rrugës “28 nëntori” dhe Rrugës “Abdi Toptani”, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Techno-Alb” sh.p.k, miratuar me vendimin Nr. 10 datë 02.02.2018, të ndryshuar me vendimin Nr. 31 datë 10.06.2021 të KKT-së.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë që përmenden në pikën 2, të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 31 datë 10.06.2021 “Për disa ndryshime në disa vendime të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe delegimin e kompetencave”, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Marrëveshja përkatëse për delegimin e kompetencave, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 10 datë 02.02.2018 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin “Godinë polifunksionale 4, 5, 11 dhe 21 kate, me 3 kate nëntokë “Book Building”, ndërmjet




7
Rrugës “28 nëntori” dhe Rrugës “Abdi Toptani, Bashkia Tiranë”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi.

4. Të gjitha procedurat administrative/ligjore për miratimin e rishikimeve dhe/ose ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit dhe shtyrjen e afateve, të parashikuara në nenet 17, 17/1, 18 të VKM-së 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, do të vijohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat ligjore të Ligj Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të ti, ndërsa çertifikata e përdorimit referuar nenit 27 të VKM-së 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, do të lëshohen nga sekretariati teknik i KKT-së.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 12 /12/ 2024